



STATUTI

Organizata Ndërkombëtare e Policisë

IPA - SEKSIONI ALBANIA

Në bazë të Neneve 39-53 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit, Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jo Fitimprurëse” i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Policisë Ndërkombëtare – Seksioni Albania, në mbledhjen e saj të mbajtur më datën 10 Tetor 2017, në Tiranë, ka miratuar, plotësuar dhe redaktuar statutin e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë “Seksioni Albania”, në përputhje me gjuhën teknike dhe formuluar në bazë të tekstit original të I.P.A. teksti i Statutit “Internacional Police Association” – Seksioni Albania,

Me anetare themelues :

1. **Bilbil MEMAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Shefqetit, dtl. 15.02.1959, lindur dhe banues ne Tiranë, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me Leternjoftimin Nr. 025463189,
2. **Satedin FISHTA**, shtetas shqiptar, i biri i Bajramit, i dtl. 15.03.1956, lindur ne Shkoder e banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Leternjoftimin Nr. 024609718
3. **Artan SHKEMBI**, shtetas shqiptar, i biri i Pajos, i dtl, 11.10.1967, lindur ne Fier e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten Nr. BF2208242,
4. **Gentjan SHEHAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Agronit, i dtl 14.10.1976, lindur ne Dajsh, Fier e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 024399018
5. **Armando MANDRO**, shtetas shqiptar, i biri i Harillarit, i dtl. 26.11.1970, lindur ne Kucove e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 024417629

1

6. **Xhevair KARAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Farikut, i dtl. 24.02.1964, lindur ne Arramenas Kruje e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 0129852592
7. **Vladimir IKONOMI**, shtetas shqiptar, i biri i Zoit, i dtl. 05.01.1959, lindur ne Skrapar, e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 024452052
8. **Mehmet BAKIU**, shtetas shqiptar, i biri i Feritit, i dtl 29.07.1960, lindur ne Berat e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr 028092871
9. **Hamza BODLI**, shtetas shqiptar, i biri i Myslimit, i dtl. 01.04.1958, lindur ne Durres, e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr 029809435
10. **Lavdim KAZAZI**, shtetas shqiptar, i biri Agimit, i dtl. 22.05.1978, lindur e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr 024490239
11. **Ardian ZAGANJORI**, shtetas shqiptar, i biri i *Shuaip* i dtl. 14.07.1968, lindur ne Shkoder e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten Nr. BB5744741

KAPITULLI I

EMËRI I SHOQATËS DHE VENDNDODHJA, FUSHA E VEPRIMIT, MOTOJA, EMBLEMA, BAZA LIGJORE.


Neni 1

Krijohet shoqata, "Organizata Ndërkombëtare e Policisë, Seksioni Albania", me term të shkurtuar, IPA, "Internacional Police Association" Seksioni Albania, në kuadër të veprimtarive profesionale, kulturore, sociale dhe sportive.

Neni 2

Veprimtaria e Shoqatës IPA "Seksioni Albania", shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqata dhe degët e saj janë person juridik dhe fitojnë personalitetin juridik sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3



Handwritten signatures of the signatories, including a prominent signature that appears to be 'L. L. L. L.' and another that appears to be 'L. L. L. L.' with a '2' written next to it.

Selia e seksionit kombëtar, Seksioni I IPA-Albania është në Tiranë, me adresë Akademia e Sigurise, Sauk.

Neni 4

Motoja e shoqatës ndërkombëtare është “Servo për Amikeco” në gjuhën Esperanto, që në shqip do të thotë “Shërbim përmes Miqësisë”.

Neni 5

a) Emblema e Shoqatës është e miratuar nga IPA dhe ka formën e një globi e rrethuar me fjalët “Shoqata Ndërkombëtare e Policisë” (International Police Association) dhe “Servo per Amikeco” (Shërbimi përmes Miqësisë) dhe mbrohet nga e drejta e autorit.

Ana e jashtme e globit është e rrethuar nga gjethet e dafinave, duke filluar në skajet dhe që e rrethon pothuajse deri në majë duke formuar një rreth. Në krye të rrethit është gdhendur teksti “Seksioni Albania”. Teksti mbi vulën është shtypur në gjuhën shqipe në gërma latine.

b) Emblema mund të përdoret vetëm nga Seksioni Albania - IPA, strukturat dhe anëtarët e shoqatës, por jo për qëllime komerciale.

Neni 6

Ky statut mbështetet në statutin ndërkombëtar të IPA-s dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

KAPITULLI II

QËLLIMI, DETYRAT DHE METODAT E IMPLEMENTIMIT TË TYRE

Neni 7

1. IPA- Seksioni Albania, është në favor te bashkëpunimit me gjithë seksionet e tjera. Qëllimi dhe detyra kryesore është që të krijojë lidhjet e miqësisë dhe shoqërisë së vërtetë profesionale midis pensionistëve dhe të punësuarve në shërbimin policor në Shqipëri dhe në botë, si dhe për të krijuar bashkëpunim ndërkombëtar dhe promovimin e idesë së tolerancës në të gjitha fushat kulturore dhe për të kontribuar në mirëkuptimin ndërmjet popujve.

2. Përveç kësaj, objektivat e Shoqatës kryesisht janë:

a) Zhvillimi i kontakteve kulturore midis anëtarëve të saj.

b) Përmirësimi i njohurive të përgjithshme dhe shkëmbimit të përvojave profesionale.



c) Kryerjen e bamirësisë dhe aktiviteteve sociale.

d) Kontributi për bashkëjetesën paqësore të popujve dhe ruajtjen e paqes në botë.

3. Shoqata është e angazhuar për respektimin e parimeve të përcaktuara në Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut të miratuar në vitin 1948, nga Kombet e Bashkuara.

4. IPA Seksioni Albania është asnjëherë ndaj organizatave politike, sindikatave, bashkësive dhe organizatave fetare dhe ndjek për arritjen e detyrave të saj vetëm objektivat ideologjike të shoqatës.

5. Struktura e IPA Seksioni Albania janë të nevojshme për të marrë pjesë aktivisht në arritjen e objektivave të IPA-s në bazë të këtij Statuti.

Neni 8

Për të arritur objektivat Shoqata synon në veçanti:

1. Kryerja e simpoziumeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, takime dhe seminare për studime profesionale, kulturore dhe problemeve të tjera.

2. Promovimin dhe kryerjen e udhëtimeve individuale dhe grupe studimore.

3. Promovimin dhe kryerjen e eventeve, për edukimin e të rinjve (udhëtime, seminare, aktivitete sportive etj).

4. Shkëmbimin dhe publikimin e informacionit në fushën e aktiviteteve profesionale kryesisht nëpërmjet revistës IPA - Seksioni Albania.


5. Zhvillimin e kontakteve personale me anëtarët e seksioneve të tjera kombëtare në frymën e mirëkuptimit dhe ndihmës reciproke, si dhe inkurajon përfshirjen e familjarëve të anëtarëve, bashkëshort/bashkëjetues dhe fëmijë.

6. Forcimin e ndjenjës së respektit për ligjin dhe rendin midis shërbimeve policore.

7. Rritjen e prestigjit në publik të punonjësve të policisë së shtetit, duke përmirësuar gjendjen e njohurive në lidhje me formacionet në shoqëri dhe përmirësimin e marrëdhënieve midis publikut dhe policisë.

8. Promovimin dhe lehtësimin e shkëmbimit të përvojave me anëtarët e seksioneve të tjera kombëtare, për rritjen e njohurive profesionale dhe të përgjithshme.

9. Bashkëpunimi në përgatitjen e bibliografisë shqiptare dhe ndërkombëtare të punimeve për problemet e policisë dhe shoqatës.



Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including a large signature on the right and several smaller ones on the left.

10. Zhvillimi i bashkëpunimit në sferën profesionale, sociale, kulturore, sportive dhe turizmit me seksionet e tjera kombëtare simotra, si edhe ndërmjet strukturave në vend.

11. Inicimin e shkëmbimit të korrespondencës për ruajtjen dhe marrjen në kontakt dhe për të mbështetur zhvillimin e gjuhëve të huaja.




KAPITULLI III

ANËTARËSIA, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE, DËSHMIA E ANËTARËSISË, PËRFUNDIMI I ANËTARËSISË

Neni 9

1. Anëtarësimi në shoqatë është vullnetar.
2. Do të jenë tre kategoritë e anëtarësimit në Shoqatë
 - a) anëtarë të zakonshëm
 - b) anëtarë të jashtëm
 - c) anëtarë nderi.
3. Anëtarë i zakonshëm në IPA - Seksioni për Shqipërinë, mund të jetë çdo punonjës i Policisë së Shtetit aktiv, i dalë në reform, në pension të parakohshëm, pension pleqërie, me edukim policor. Anëtarë mund të jenë edhe punonjësit e MB të Shqipërisë që mbajnë gradë policore, të cilët nuk janë dënuar për një vepër penale të qëllimshme, që ndiqet kryesisht nga prokuroria.
4. Anëtarë të jashtëm janë punonjësit e policisë në detyrë apo pension, të vendeve të tjera, në qoftë se një shoqatë/seksion kombëtar i tillë nuk ekziston në vendin e tyre, por nuk mund të emërohen në funksione zyrtare të Shoqatës IPA - Seksioni Albania.
5. Anëtarë nderi janë bashkëshortet/ët e vet anëtarëve të shoqatës, që kanë ndërruar jetë, por nuk mund të emërohen në funksione zyrtare të shoqatës. Anëtarë nderi mund të jenë edhe shtetas shqiptarë ose të huaj, për kontributin e shquar për arritjen e qëllimeve dhe objektive të Shoqatës.
6. Asambleja e Përgjithshme (ose Kongresi), me një rezolutë, mund të shtojë kriteret për anëtarësimin në shoqatë.
7. Anëtarësimi i zakonshëm mund të merret në degën e IPA-s, Seksioni Albania pas plotësimit të një deklaratë dhe një pagesë kuotizacioni vjetor të anëtarësisë.



Neni 10

Dëshmia e Anëtarësisë

1. Anëtarët e IPA "Seksioni Albania" kanë të drejtë:

- a) Të votojnë dhe të votohen apo të zgjidhen në organet e shoqatës. Anëtarët e zakonshëm kanë të drejtë të kandidojnë për çdo lloj funksioni në shoqatë nëse plotësojnë kushtet e parashikuara në statut.
- b) Të marrin pjesë në kryerjen e detyrave apo funksioneve të shoqatës.
- c) Të paraqesë propozime dhe sugjerime për veprimtaritë e shoqatës.
- d) Kandidati për funksion mund të marrë pjesë në mbledhjen e themelimit të Asamblesë të Shoqatës vetëm nëse është anëtarë I IPA të Seksionit.

2. Detyrimi i çdo anëtari është:

- a) Të ndjekë realizimin e qëllimeve dhe detyrave të shoqatës, të respektojë dhe të zbatojë Statutin dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës.
- b) Të paguajë tarifën vjetore të shoqatës, jo më vonë se data 31 Mars, shumë e cila përcaktohet nga Komisioni Ekzekutiv Kombëtar dhe pagesa e zakonshme e tarifës së anëtarësisë është kusht për pjesëmarrje në punën e organeve drejtuese të Shoqatës.


3. Anëtari që paguan tarifën vjetore për anëtarësim pas datës 31 Mars, por jo më vonë se 30 Qershor i vitit në vazhdim, nuk mund të kandidojë në organet drejtuese e menaxhuese të shoqatës. Anëtarët e nderit përjashtohen nga pagesa e tarifës vjetore të anëtarësimit.

Neni 12

Përfundimi i anëtarësisë

1. Anëtarësia përfundon për shkak të:

- a) Largimit vullnetar nga shoqata
- b) Mospagimit të tarifës së anëtarësisë për një periudhë më të gjatë se një vit
- c) Vdekjes së një anëtari
- d) Dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një krimi me dashje, që ndiqet kryesisht nga prokuroria
- e) Përjashtimit për shkelje të rënda të Statutit të IPA-s dhe Rregullores. Vendimin e përjashtimit për sjellje që janë në kundërshtim me statutin dhe rregulloren, merret me $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të pranishëm të Komisionit Ekzekutiv Kombëtar. Ankimi ndaj vendimit bëhet në Asamblenë Kombëtare.



A series of approximately seven handwritten signatures in black ink, arranged horizontally across the bottom of the page. The signatures vary in style and length, some appearing to be initials or full names.

2. Në rastin e përfundimit të anëtarësimit, tarifa e paguar paraprakisht nuk kthehet. Një anëtar i cili është larguar mbi bazën e mospagimit të anëtarësisë, mund të bëhet përsëri anëtarë, menjëherë pas pagesës së tarifës anëtarësimit vjetor.



Kapitulli V

BURIMET FINANCIARE TË SHOQATËS

Neni 13


Burimet financiare

Burimet financiare të shoqatës janë:

- Tarifat e anëtarësimit,
- Grantet dhe donacionet,
- Burime të tjera të lejuara me ligj,
- Në shoqatë dhe në degët rajonale ndalohet dhënia e kredive ose sigurimi i garancisë pasurore, transferimi i aseteve nga organizata te anëtarët e saj, ose te të punësuarit në organet e shoqatës, si dhe çdo veprim tjetër që ndalohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 14

Tarifa vjetore e anëtarësimit paguhet në numrin e llogarisë të Seksionit Kombëtar. Pjesë e tarifës së anëtarësisë, shumën e cila është përcaktuar nga Këshilli Ndërkombëtar i IPA i paguhet thesarit të Shoqatës Ndërkombëtare të Policisë në Zvicër, si taksë ndërkombëtare, të destinuara për funksionimin normal të administratës së IPA-s. Pjesa e mbetur e të ardhurave (kuotizacion, grante donacion, burime të tjera ligjore) përdoren nga Seksioni Ndërkombëtar dhe degët rajonale për realizimin e objektivave profesionale, kulturore dhe sociale si edhe për mbulimin e shpenzimeve dhe funksionimin e rregullt të organeve administrative. Vendimi për ndarjen e fondit të krijuar nga kuotizacioni vjetor, merret nga Komisioni Ekzekutiv Kombëtar, dhe fondi i krijuar pas shlyerjes së detyrimeve për anëtarësimin ndërkombëtar, shpërndahet në raportin 60% Seksioni Kombëtar, dhe 40% dega rajonale përkatëse, në proporcion me numrin e anëtarëve të degës. Degët rajonale fondin e mbetur prej 40% e shpenzojnë për realizimin e objektivave dhe veprimtarive të parashikuara në statut. Të ardhurat nga grantet dhe donacionet, si dhe nga burimet e tjera të lejuara me ligj, që i kalojnë degëve dhe/ose seksionit kombëtar, mbahen të regjistruara në librin e llogarisë së shoqatës.



KAPITULLI VI

KAPITULLI VI

STRUKTURA DHE AUTORITETET KOMBËTARE TË SHOQATËS

Neni 15

1. IPA, Seksioni Albania është shoqatë kombëtare dhe përbëhet nga degët rajonale. Degët rajonale janë njësitë bazë dhe strukturat vendore të shoqatës. Çdo degë e ushtron aktivitetin brenda juridiksionit territorial të Drejtorisë Vendore të Policisë.
2. Krijimi i degëve rajonale miratohet nga Komisioni Ekzekutiv Kombëtar.
3. Dega rajonale përbëhet nga të paktën 10 anëtarë.

Neni 16


1. Autoritetet më të larta të shoqatës janë:
 - a) Asambleja Kombëtare e Shoqatës (Kongresi)
 - b) Asambleja e Përgjithshme Rajonale
2. Autoritetet drejtuese të shoqatës janë:

Bordi Kombëtar
3. Autoritetet ekzekutive janë:
 - a) Komisioni Kombëtar Ekzekutiv
 - b) Komisioni Rajonal Ekzekutiv
4. Komisioni Auditues, është një organ kolegjal i veçantë i kontrollit të brendshëm dhe anëtarët e këtij komisioni nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese dhe ekzekutive, apo në lidhje të afërt gjinie dhe krushqie me ta.

Neni 17

Asambleja e Përgjithshme Kombëtare

1. Autoriteti më i lartë i IPA Seksioni Albania, do të jetë Asambleja e Përgjithshme Kombëtare (kongresi). Delegatët do të zgjidhen nga Asambleja e degëve rajonale duke ruajtur proporcionalitetin 1 delegat për 10 anëtarë. Mandati i delegatit do të përfundojë pas rezolutës së Bordit Kombëtar për thirrjen e Kongresit të ardhshëm të zakonshëm.
2. Mënyrat e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme Kombëtare janë:



A horizontal row of approximately seven handwritten signatures in black ink, located at the bottom of the page. The signatures vary in style and length, some appearing more formal and others more cursive.

- a) I zakonshëm, kur thirret nga Bordi Kombëtar me kërkesë të Komisionit Ekzekutiv Kombëtar
- b) I jashtëzakonshëm, kur thirret me kërkesë të 1/3 të Degëve Rajonale, ose me kërkesë të Komisionit Kombëtar Ekzekutiv, duke deklaruar qëllimin dhe arsyen për thirrjen.
3. Kongresi do të jetë ligjrisht i vlefshëm nëse marrin pjesë të paktën gjysma e delegatëve.
4. Rezolutat e Kongresit miratohen me shumicë të thjeshtë të delegatëve, me përjashtim të rasteve kur dispozitat e Statutit parashikojnë ndryshe.
5. Kushtet, rregullat dhe procedurat e hollësishme në lidhje me thirrjen e Kongresit të delegatëve parashikohen në Rregullore.

Neni 18


Kompetenca


Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme Kombëtare janë:

1. Zgjedhja e Presidentit të Shoqatës IPA - Seksioni Albania.
2. Miratimi i programeve dhe aktiviteteve kryesore të Shoqatës.
3. Zgjedhja dhe shkarkimi i anëtarëve të Komisionit Ekzekutiv Kombëtar dhe Komisionit të Auditimit
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raporteve të aktiviteteve të Bordit Kombëtar dhe Komisionit të Auditimit.
5. Miratimi i rezolutës për shpërndarjen e Shoqatës dhe rregullimin e aseteve të saj.
6. Ndryshime në Statutin e Shoqatës.
7. Përcaktimi i metodës së Financimit.
8. Përcaktimi i numrit të anëtarëve të Komisionit Ekzekutiv Kombëtar dhe Komisionit të Auditimit.
9. Shqyrtimi i ankesave kundër vendimeve të Bordit Kombëtar, Komisionit Kombëtar Ekzekutiv dhe Komisionit të Auditimit. Vendimet e marra nga Asambleja janë përfundimtare.


Neni 19

Bordi Kombëtar





1. Bordi Kombëtar është organ drejtues për periudhën midis dy kongreseve dhe autoritetit kompetent miratues.
2. Bordi Kombëtar përbëhet prej anëtarëve të Komisionit Ekzekutiv Kombëtar dhe të Kryetarëve të degëve Rajonale.
3. Mbledhja e Bordit Kombëtar thirret nga Komisioni Kombëtar Ekzekutiv, të paktën një herë në gjashtë muaj dhe drejtohet nga presidenti ose prej një anëtar të komisionit i autorizuar prej Presidentit.



Neni 20

Kompetenca



Kompetencat e Bordit Kombëtar kryesisht janë:

1. Miratimi i vlerësimit të buxhetit
2. Miratimi i pasqyrave financiare dhe bilanceve në përputhje me rregullat financiare.
3. Për të vendosur mbi sasinë dhe rregullat e shpërndarjes së kuotave të anëtarësisë në shoqatë.
4. Vendimi për përjashtimin e një anëtar nga shoqata.
5. Dhënien e çmimeve dhe miratimin e kandidatëve të nderuar.
6. Mbikëqyrja e Komisionit Kombëtar Ekzekutiv në menaxhimin e çështjeve financiare të shoqatës.
7. Miratimi dhe organizimi i Zyrës së Bordit Kombëtar.
8. Ngritjen e Komisioneve për qëllime të caktuara statusore.
9. Emërimin e krye-Redaktorit të Revistës së Shoqatës dhe Stafit Administrativ.
10. Miratimi i ndryshimeve të Rregullores/ve.
11. Shqyrtimi i ankesave kundër vendimeve të organeve drejtuese të nivelit të ulët. Vendimet e marra në këtë mënyrë janë përfundimtare.

Neni 21

Përfaqësimi

Përfaqësimi i shoqatës bëhet nga Presidenti, Zv./Presidenti me autorizimin e Presidentit, ose nga një anëtar i Komisionit Kombëtar Ekzekutiv.



2. Procedura dhe rregullat për kryerjen e përfaqësimit, duke përfshirë zëvendësimin e zyrtarëve të shoqatës, përcaktohen në Rregulloren e Shoqatës

Neni 22

Komisioni Ekzekutiv Kombëtar

1. Komisioni Ekzekutiv Kombëtar është organi ekzekutiv që trajton çështjet aktuale. Përveç se kur Asambleja Kombëtare vendos ndryshe, Komisioni përbëhet nga:
 - a. Presidenti
 - b. Zv./Presidenti I Zv./ Presidenti II
 - c. Sekretari Përgjithshëm
 - d. Koordinator
2. Veprimtaria e Komisionit Kombëtar Ekzekutiv drejtohet nga kryetari
3. Komisioni Kombëtar Ekzekutiv mund të kërkojë nga Byroja Kombëtare organizimin e Zyrës Kombëtare të Bordit dhe zgjidhjen e çështjes së komisioneve për qëllime të veçanta statusore
4. Komisioni Kombëtar Ekzekutiv do të mbledhet me kërkesë të Presidentit, ose me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të tij, jo më pak se 4 herë në vit.


Neni 23

Kompetencat

Kompetencat e Komisionit Kombëtar Ekzekutiv, kryesisht janë:

- 1) Menaxhimi aktual i punës së shoqatës
- 2) Mbikëqyrja e aktiviteteve dhe emërimin e asistentëve për kontakte me Seksionet kombëtare të IPA-s të vendeve të tjera
- 3) Mbikëqyrja e redaktimit të Revistës Kombëtare të IPA-s
- 4) Përgatitjen e takimeve të Bordit Kombëtar
- 5) Përgatitjen e projektit dhe zbatimit të vlerësimit të buxhetit
- 6) Përgatitjen e rregullave për situata kur në statut kur nuk janë parashikuar dhe është e nevojshme për funksionimin efikas të Shoqatës
- 7) Përcaktimit të llojit të dokumentacionit, rregullat dhe afatet e raportimit nga ana e degëve rajonale, sipas nevojave të autoritetit kombëtar dhe ndërkombëtar të IPA-s
- 8) Përcaktimin e përgjegjësive të zyrtarëve të Komisionit Ekzekutiv Kombëtar
- 9) Mbikëqyrjen e punës së zyrës së Bordit Kombëtar dhe Komisioneve të emëruara
- 10) Rregullat e hollësishme për raportim përcaktohen në Rregullore

Neni 24



11

Komisioni i Auditimit

1. Komisioni i Auditimit duhet të zgjidhet nga autoriteti kompetent në nivel kombëtar dhe rajonal
2. Kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit kanë të bëjnë me anën organizative strukturore të Shoqatës dhe degëve
3. Komisioni do të përbëhet nga të paktën tre anëtarë, të cilët do të zgjedhin një kryetar mes tyre
4. Kryetari fillon kontrollet dhe është përgjegjës për kryerjen e detyrave statusore të përcaktuara. Grupi i auditimit mund të përfshijë anëtarë nga komisioni i auditimit në nivel rajonal
5. Mënyra dhe aktivitetet e detajuara të Komisionit përcaktohen në Rregullore

Neni 25



Përgjegjësitë

Detyrat e Komisionit të Auditimit, kryesisht janë:

- 1) Kontrolli i organeve drejtuese dhe ekzekutive të të njëjtit nivel, të paktën një herë në vit dhe në çdo rast, pas bilancit në fund të vitit në kuadër të:
 - a) Rregullsisë së planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit dhe bilancit financiar, me theks të veçantë në fondet e ngritura nga shoqata në lidhje me përfitimet publike të aktiviteteve të organizatës.
 - b) Aktivitetet statusore të organeve drejtuese dhe ekzekutive
- 2) Raportimi tek autoriteti i duhur statusor i kontrolleve të kryera
 - a) Në rastin e zbulimit të veprimeve që shkelin rregullat e aplikueshme në statut
 - b) Për të përcaktuar statusin e pajtueshmërisë me rregulloret në fuqi
 - c) Për të raportuar për punën e komisionit në fund të mandatit
3. Si edhe çdo detyrë tjetër të parashikuar në statut dhe rregullore.

KAPITULLI VII

STRUKTURA DHE AUTORITETI KOMBËTAR I SHOQATËS



Neni 26

Dega Rajonale

1. Dega Rajonale do të jetë struktura bazë organizative e Shoqatës.
2. Autoriteti më i lartë lokal do të jetë Asambleja e Përgjithshme Rajonale, që thirret me vendim të Komisionit Ekzekutiv Rajonal.
3. Mbledhjet e përgjithshme të anëtarëve të degës duhet të mbahen së paku një herë në vit dhe kompetenca e tyre do të përfshijë:
 - a) përcaktimin e detyrave specifike dhe drejtimet e aktivitetit të degës;
 - b) miratimin e raporteve vjetore të Komisionit Ekzekutiv Rajonal dhe Komisionit Rajonal të Auditimit;
 - c) miratimin dhe aprovimin e buxhetit;
 - d) zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të Komisionit Ekzekutiv Rajonal dhe Komisionit Rajonal të Auditimit;
 - e) zgjedhjen e delegatëve të Asamblesë së Përgjithshme;
 - f) përcaktimin e numrit të anëtarëve të Komisionit Ekzekutiv Rajonal dhe Komisionit Rajonal të Auditimit;
 - g) shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve/rezolutave të Komisionit Ekzekutiv Rajonal dhe ndaj konkluzioneve audituese të Komisionit Rajonal të Auditimit.

Neni 27

Komisioni Ekzekutiv Rajonal

1. Autoriteti drejtues dhe ekzekutiv i degës rajonale është Komisioni Ekzekutiv Rajonal, i cili përbëhet nga:
 - a) Kryetari
 - b) Sekretari
 - c) Anëtari që ngarkohet me mbajtjen e llogarisë.
2. Veprimtaria e Komisionit Ekzekutiv Rajonal drejtohet nga kryetari.
3. Mbledhjet e Komisionit bëhen me kërkesë të njërit prej anëtarëve të tij.

Neni 28

Detyrat

Detyrat e Komisionit Ekzekutiv Rajonal, kryesisht janë:

- 1) zbatimi i vendimeve të Asamblesë dhe menaxhimi aktual i aktiviteteve rajonale;



- 2) përgatitja dhe zbatimi i vlerësimeve të projektit;
- 3) përgatitja e një raporti vjetor mbi punën e komisionit dhe raportit financiar;
- 4) thirrja e mbledhjeve të anëtarëve të degës;
- 5) raportimi periodik mbi aktivitetet e degës.

Neni 29

Kohëzgjatja e mandatit

1. Kohëzgjatja e mandatit në të gjitha organet e shoqatës është për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë ri-zgjedhjeje.
2. Kandidatët nuk mund të propozohen apo të zgjidhen në një pozicion pa dëshirën e tyre.
3. Propozimet dhe kandidaturat duhet të bëhen midis delegatëve në asamble.
4. Rregulla të veçanta të detajuara për zgjedhjen e strukturave dhe procedurat e zgjedhjes, përcaktohen në Rregullore.

Neni 30

Zgjedhja e funksionarëve

1. Zgjedhjet për organet drejtuese të shoqatës dhe degës do të jenë publike, përveç nëse Asambleja vendos ndryshe.
2. Kandidati konsiderohet i zgjedhur për pozicionin ku kandidon, pas marrjes së më shumë se gjysmës së votave të delegatëve të pranishëm.
3. Në rast se kandidati i vetëm nuk merr shumicën e kërkuar të votave, duhet propozuar një tjetër kandidat.
4. Në rast aplikimi të dy ose më shumë kandidatë për të njëjtin pozicion, votimi kryhet i fshehtë.
5. Nëse kandidati nuk merr 50% + 1 të votave në raundin e parë, zgjedhja e kandidatit do të bëhet në raundin e ardhshëm, midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave.

Neni 31

1. Përcaktimi i sasisë dhe mënyrat e shpërndarjes së kontributeve, do të jetë në kompetencë të autoriteteve të Shoqatës.

2. Rregullat e regjistrimit dhe të përdorimit të fondeve të parashikuara për IPA pas zbritjeve të pagesave tatimore të mundshme për organizatat jofitimprurëse, bëhet sipas parashikimeve në Rregullore.
3. Kontabiliteti i Shoqatës do të kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregullore.

KAPITULLI VIII

AMENDAMENTET STATUTORE DHE MBARIMI I SHOQATËS

Neni 32

Ndryshimi i statutit

1. Kërkesa për të ndryshuar Statutin e Shoqatës i paraqitet Bordit Kombëtar nga:

- a) Komisioni Kombëtar Ekzekutiv
- b) Komisioni Rajonal Ekzekutiv


Nëse kërkesa mbështetet nga Bordi Kombëtar, ky i fundit emëron Komisionin Statusor, në mënyrë që të zhvillojnë projekt-ndryshimet në statut.

2. Vendimi i Asamblesë Kombëtare për ndryshimet në Statutin e Shoqatës, do të jetë i vlefshëm nëse votohet në favor nga së paku $\frac{3}{4}$ e votave, në prani të së paku $\frac{3}{4}$ e delegatëve.
3. Mënyra e emërimit, qëllimi dhe kohëzgjatja e punës së Komisionit Statusor, përcaktohen në Rregullore.

Neni 33

Shpërndarja e shoqatës

1. Kërkesa për shpërndarjen e Shoqatës mund të bëhet nga $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të Bordit Kombëtar, ose $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të Shoqatës.
2. Bordi Kombëtar thërret Kongresin e jashtëzakonshëm brenda 6 muajve nga data e marrjes së kërkesës.
3. Kongresi i jashtëzakonshëm vendos shpërndarjen e Shoqatës me një shumicë prej të paktën $\frac{3}{4}$ e votave, në prani të së paku të $\frac{3}{4}$ e delegatëve.



4. Në rast të shpërndarjes së Shoqatës, pasuria e saj do ti transferohet organizatës/ave profesionale të punonjësve të policisë.

KAPITULLI IX

DISPOZITA KALMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 34

Komisioni Ekzekutiv Kombëtar do të jetë përgjegjës për hartimin e Rregullores së parashikuar në statut. Rregullorja do të miratohet me vendim të Bordit Kombëtar.

Për rastet që nuk parashikohen në këtë statut, do të zbatohet legjislacioni që rregullon veprimtarinë e shoqatave.


Neni 35

Ky statut u përpunua dhe u miratua nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të grupit iniciator, të cilët votuan dhe nënshkruajnë në unanimitet më datën 25 Shtator 2017.


Deri në krijimin e degëve rajonale dhe thirrjen e Kongresit të Parë, krijohet Komisioni i Përkohshëm Drejtues i IPA "Seksioni Albania", me përbërjen e grupit iniciator të mëposhtëm, i cili do të drejtojë dhe përfaqësojë shoqatën deri në krijimin dhe zgjedhjen e autoriteteve kompetente të parashikuara në statut.

Komisioni (Grupi Iniciator):

1. Drejtues i Lartë Dr. Bilbil Memaj (Kryetari) *Bilbil Memaj*
2. Drejtues Artan Shkëmbi (Zv/kryetar) *Artan Shkëmbi*
3. Drejtues Gentjan Shehaj (Zv/kryetar) *Gentjan Shehaj*
4. Kryekomisar Lavdim Kazazi (Koordinator) *Lavdim Kazazi*




- 5. Drejtues Hamza Bodlli (Sekretar) *Hamza Bodlli*
- 6. Drejtues i Parë Xhevair Karaj *Xhevair Karaj*
- 7. Drejtues Armando Mandro *Armando Mandro*
- 8. Drejtues Vladimir Ikonimi *Vladimir Ikonimi*
- 9. Drejtues Besnik Baku *Besnik Baku*
- 10. Nënkomisar Ardjan Zaganjori *Ardjan Zaganjori*
- 11. Drejtues Setedin Fishta *Setedin Fishta*



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 20/10/2017 (dymije e shtatembdhjete), perpara meje Notere Elida Magani, me seli ne Rr. "Pr. G. W. Bush", Kulla 2, Tirane, u paraqiten personalisht :

1. **Bilbil MEMAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Shefqetit, dtl. 15.02.1959, lindur dhe banues ne Tiranë, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me Leternjoftimin Nr. 025463189,
2. **Satedin FISHTA**, shtetas shqiptar, i biri i Bajramit, i dtl. 15.03.1956, lindur ne Shkoder e banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Leternjoftimin Nr. 024609718
3. **Artan SHKEMBI**, shtetas shqiptar, i biri i Pajos, i dtl. 11.10.1967, lindur ne Fier e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten Nr. BF2208242,
4. **Gentjan SHEHAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Agronit, i dtl. 14.10.1976, lindur ne Ballsh, Fier e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 024399018
5. **Armando MANDRO**, shtetas shqiptar, i biri i Harillarit, i dtl. 26.11.1970, lindur ne Kucove e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 024417629
6. **Xhevair KARAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Farikut, i dtl. 24.02.1964, lindur ne Arramenas Kruje e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 0129852592
7. **Vladimir IKONOMI**, shtetas shqiptar, i biri i Zoit, i dtl. 05.01.1959, lindur ne Skrapar, e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 024452052
8. **Besnik BAKIU**, shtetas shqiptar, i biri i Feritit, i dtl. 29.07.1960, lindur ne Berat e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 028092871
9. **Hamza BODLI**, shtetas shqiptar, i biri i Myslimit, i dtl. 01.04.1958, lindur ne Durres, e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 029809435
10. **Lavdim KAZAZI**, shtetas shqiptar, i biri Agimit, i dtl. 22.05.1978, lindur e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr. 024490239






10. **Lavdim KAZAZI**, shtetas shqiptar, i biri Agimit, i dtl. 22.05.1978, lindur e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr 024490239

11. **Ardian ZAGANJORI**, shtetas shqiptar, i biri i Farikut, i dtl. 14.07.1968, lindur ne Shkoder e banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten Nr. BB5744741

Te cilet deklarojne se ka nenshkuar rregullisht para meje Noteres Statutin e Shoqates "I.P.A. ALBANIA", dhe une Noterja vertetoj neneshkrimin e tyre sipas Ligjit.

Notere

Elida MAGANI




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

NUMER VENDIMI 5700

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË, E PERBERE NGA:

MARINELA OSMANI – GJYQTARE

Sot me date **30.11.2017**, mora ne shqyrtim kerkesen qe i perket:

KERKUES: Shoqata “IPA - SEKSIONI ALBANIA”, perfaqesuar nga Presidenti Bilbil Memaj

OBJEKTI: Regjistrimi në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse i Shoqatës “IPA - SEKSIONI ALBANIA, depozitimi në këtë regjistër i aktit të themelimit dhe statutit të shoqatës dhe dokumenteve të tjera përkatëse.

BAZA LIGJORE: Kodi Civil, Ligji Nr.8788, date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimprurëse”, Ligji Nr.8789, date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kerkeses dhe te akteve bashkelidhur saj;

V E R E N

1. Me kerkesen drejtuar kesaj Gjykate, kerkohet regjistrimi në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse i Shoqatës “IPA - SEKSIONI ALBANIA, depozitimi në këtë regjistër i aktit të themelimit dhe statutit të shoqatës dhe dokumenteve të tjera përkatëse.

Nga provat shkresore te paraqitura nga ana e pales kerkuese, rezultoi e provuar se:

2. Në bazë të Aktit të Themelimit dhe Statutit është themeluar Shoqata “IPA - SEKSIONI ALBANIA” një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse me anëtaresi. Shoqata është selinë në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Akademia e Sigurisë, Sauk, Tiranë.

3. Objekti i veprimtarive të Shoqatës është: IPA- Seksioni Albania, është në favor te bashkëpunimit me gjithë seksionet e tjera. Qëllimi dhe detyra kryesore është që të krijojë lidhjet e miqësisë dhe shoqërisë së vërtetë profesionale midis pensionistëve dhe të punësuarve në shërbimin policor në

Shqipëri dhe në botë, si dhe për të krijuar bashkëpunim ndërkombëtar dhe promovimin e idesë së tolerancës në të gjitha fushat kulturore dhe për të kontribuar në mirëkuptimin ndërmjet popujve. Përveç kësaj, objektivat e Shoqatës kryesisht janë:

- a) Zhvillimi i kontakteve kulturore midis anëtarëve të saj.
- b) Përmirësimi i njohurive të përgjithshme dhe shkëmbimit të përvojave profesionale.
- c) Kryerjen e bamirësisë dhe aktiviteteve sociale.
- d) Kontributi për bashkëjetesën paqësore të popujve dhe ruajtjen e paqes në botë.

4. Shoqata është e angazhuar për respektimin e parimeve të përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të miratuar në vitin 1948, nga Kombet e Bashkuara. IPA Seksioni Albania është asnjëherë ndaj organizatave politike, sindikatave, bashkësive dhe organizatave fetare dhe ndjek për arritjen e detyrave të saj vetëm objektivat ideologjike të shoqatës.

5. Struktura e IPA Seksioni Albania janë të nevojshme për të marrë pjesë aktivisht në arritjen e objektivave të IPA-s në bazë të këtij Statuti. Te ardhurat që mund të sigurohen nga pasuritë e shoqatës, dhe aktivitetet e tjera të shoqatës do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektivave të shoqatës. Kushtet e pranimit dhe largimit të anëtarëve të shoqatës përcaktohen në statut.

6. Kohëzgjatja e Shoqatës është për një periudhë të pacaktuar. Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqatës është Asambleja e Përgjithshme Kombëtare (Kongresi), i përbërë me përfaqësim të anëtarëve të Shoqatës.

7. Në bazë të Statutit të Shoqatës "IPA - SEKSIONI ALBANIA, janë përcaktuar dhe zgjidhur të gjitha kërkesat e domosdoshme të parashikuara në ligjin "Për organizatat jofitimpruese", Ligjin Nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimpruese" dhe në Kodin Civil.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 24-53/1 të Kodit Civil, ligji Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimpruese", ligji Nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimpruese";

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Regjistrimin e personit juridik, Organizatës Jofitimpruese, Shoqatës IPA - SEKSIONI ALBANIA, me seli në Tiranë, Adresa: Akademia e Sigurisë, Sauk, me përfaqësim ligjor Presidentin Bilbil Memaj.
3. Urdhërohet Sekretari i Regjistrimit për regjistrimin dhe hapjen e dosjes përkatëse të Regjistrimit për depozimin e Aktit të Themelimit, Statutit të Shoqatës dhe akteve të tjera të themelimit.

U shpall në Tiranë, sot me datë 30.11.2017

**GJYQTARE
MARINELA OSMANI**

